



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.872/5 prot.

Tiranë më 16.6.2023

REKOMANDIM

Nr. 32, datë 16.6.2023

PËR KONTROLLUESIN “DES REAL ESTATE SH.P.K.”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “DES REAL ESTATE SH.P.K.” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 66, datë 03.05.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është shoqëri tregtare, që kryen shërbime në fushën e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme për shitjen, blerjen, dhënien me qira apo të drejtave të tjera të lidhura me to, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e marrëdhënieve franchising, në fushën e pasurive të paluajtshme, etj.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “klientë”, “agjentë-broker”, “punonjës”, “ish-punëmarrës”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi disponon arkivin fizik dhe elektronik, në të cilin, ndër të tjera, ruan të dhëna si, të dhënat e “ish-punëmarrësve”, kontratat e ndërmjetësimit për dhënie objekti me qira ose shitje prone. Konstatohet se këto të dhëna ruhen pa një afat konkret për ruajtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenin 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Përmbajtja e dosjeve personale të ish-punëmarrësve, konsiston në dokumente, të tilla si: “Kontratë individuale e punës”, “Përshkrim i postit të punës”, “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore”, “Formular personeli”, etj. Dokumenti “Formular personeli”, përmban të dhëna personale lidhur me punëmarrësin, ku ndër to përpunohen të dhëna si, kryerja e shërbimit ushtarak, të dhëna personale lidhur me familjarë/fëmijë dhe nëse janë duhanpirës ose jo, në kundërshtim kjo me parimin e mjaftueshmërisë, sipas germës “c”, të pikës 1, të nenit 5 dhe nenit 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë ato të dhëna që ka të nevojshme për të arritur qëllimin duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale lidhur me mjaftueshmërinë e të dhënave, në të cilin parashikohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Gjithashtu, gjatë plotësimit të këtij formulari, subjekti i të dhënave nuk informohet mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që gëzon (akses, korrigjim dhe fshirje), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Kur mbledh të dhëna personale, Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat

personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

4. Kontrolluesi ka lidhur “Kontratë Shërbimi” me Shoqërinë “RT Software Group SH.P.K” me objekt: “Ndërtimi dhe aktivizimi i një sistemi CRM dhe website...”. Nga analiza e kontratës konstatohet se, në të nuk parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin, në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojnë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me Përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të Përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Detyrimet e Përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e parashikimeve të Udhëzimit nr. 19.

5. Nga verifikimi i kryer në Regjistrin Elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “Njoftimi” ka mangësi në deklarin, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 1.1, të formularit të njoftimit “emri i subjektit fizik ose juridik”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “emri, mbiemri, numri i telefonit”;
- ii. Deklarimin në rubrikën 2.1, të formularit të njoftimit “fusha e veprimtarisë”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “të tjera specifiko, vetëm veprimtari që lidhen me përpunimin e të dhënave personale”;
- iii. Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “kategoritë e subjekteve të të dhënave” të tilla si, por pa u kufizuar në to “broker, etj”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 4.1, të formularit të njoftimit “kategoritë e të dhënave personale që përpunohen” të tilla si, por pa u kufizuar në to “të dhënat e familjarëve, kryerja e shërbimit ushtarak, etj.”;
- v. Deklarimin në rubrikën 5.1, të formularit të njoftimit “përpunohen të dhëna sensitive”;
- vi. Deklarimin në rubrikën 6.1, të formularit të njoftimit “qëllimi i përpunimit” të tilla si, por pa u kufizuar në to “menaxhimi i burimeve njerëzore, etj.”;
- vii. Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “marrësi i të dhënave” të tilla si, por pa u kufizuar në to “institucioneve të ndryshme shtetërore, etj.”;

viii. Deklarimin në rubrikën 10.1, të formularit të njoftimit “*masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen qartësisht mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

6. Gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se Kontrolluesi disponon një sistem elektronik, i përbërë nga CRM dhe WEB.

- CRM dhe WEB janë të ndërlidhura, por informacionet që hidhen nga secili *agent/broker* në CRM, ndahen në:
 - ✓ Informacion që mbetet në “*back office*”, informacion që i lexon dhe shikon vetëm agjenti/brokeri dhe nuk shfaqet në website. Këtu përfshihen “*regjistrimi i leads*”, “*regjistrimi i preferencave*”, “*notes*”, “*kalendari*”, “*takime*”, etj.;
 - ✓ Informacion që shfaqet në “*website*” është vetëm informacioni rreth pronës për qira ose shitje, si dhe fotografi të ambjentit.
- Hedhja e një prone të re në CRM:
 - ✓ Krijimi i lead-it (pronari i pronës) ku shkruhet “*emër*”, “*mbiemër*”, “*numri i telefonit*” dhe “*email*”;
 - ✓ Të dhënat e pronës si, “*përshkrimi i pronës*”, “*sipërfaqja*”, “*adresa*”, “*numri i telefonit të agjentit/brokerit*” dhe informacione të nevojshme për një *blerës/qiramarrës të mundshëm*;
 - ✓ Dokumente, të cilat shërbejnë për lidhjen e “*marrëveshjes broker – pronar*”, si: “*karta e identitetit*”, “*kontrata e shtëpisë*”, “*planimetria*”, etj.

Nga verifikimi në sistem, rezulton se listimi i një prone me të gjithë informacionet që përmban, edhe pasi prona nuk është më në shitje apo për dhënie me qira, ose pronari ka ndërprerë marrëveshjen me brokerin, vazhdon të ruhet pa afat në sistem, në kundërshtim kjo me gërmen “*d*” të pikës 1, të nenin 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e gërmes “*d*”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

7. Konstatohet se Kontrolluesi disponon Rregullore “*për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, por kjo rregullore nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore specifike “*për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

8. Kontrolluesi nuk ka marrë masa teknike dhe organizative të përshtatshme, për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Për sa më sipër, rezulton mos përbushje e detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI) për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, Kontrolluesi duhet të ndërmarrë masa konkrete teknike dhe organizative të përshtatshme, për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në zbatim të parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, si dhe është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore, datë 06.06.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar si dhe kanë paraqitur argumentet si vijon:

- Sa i përket konstatimit të pikës 2 të procesverbalit, në lidhje me të dhënat e agjentëve, Kontrolluesi argumenton se *“Meqënëse kjo shoqëri e ka filluar aktivitetin vitet e fundit, themi se kontratat e punës të ish-punëmarrësve janë jo më të hershme se 2-3 vitet e fundit. Afati i ruajtjes së këtyre kontratave lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me marrëdhëniet që ka shoqëria me organet e tjera shtetërore, si administrata tatimore, instituti i sigurimeve shoqërore, apo organet e tjera si, KLGJ, KLP që vlerësojnë historikun e punësimit të një individi, dhe për rrjedhojë jemi të detyruar që këto të dhëna të ruhen për një afat më të gjatë, në mënyrë që shoqëria të jetë në sinkron me afatet e përcaktuara në ligj për marrëdhëniet fiskale apo të statusit të një personi.”*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimi i ngritur nga Kontrolluesi nuk qëndron pasi, nga hetimi administrativ i ushtruar, si dhe nga Rregullorja *“për mbrojtjen e të dhënave personale”* rezulton se, nuk është parashikuar asnjë afat për të dhënat e ish-punëmarrësve, në kundërshtim me parashikimet e germës *“d”*, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit. Ndërkohë që është detyrim i shoqërisë *“Des Real Estate SH.P.K.”*, në cilësinë e Kontrolluesit, të parashikojë afate të qarta për ruajtjen e të dhënave, sipas parashikimeve të Ligjit, të cilat duhet të jenë të shkruara në rregullore dhe akte të tjera të brendshme të Kontrolluesit.

- Sa i përket konstatimit të pikës 3 të procesverbalit, në lidhje me të dhënat e Formularit të Personelit, Kontrolluesi argumenton se *“Në kontrollin fizik të Formularit të Personelit evidentohet në mënyrë të qartë, se ndonëse ky formular përmban rubrika që lidhen me shërbimin ushtarak, të dhënat personale rreth familjes/fëmijëve, nëse janë duhanpirës apo jo etj., ato mbeten dhe nuk janë të plotësuara nga punëmarrësi pasi nuk kërkohet në mënyrë urdhëruese dhënia e informacionit rreth tyre.”*

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron pasi, në Formularin e Personelit, të administruar në cilësinë e provës materiale, rezultojnë të plotësuara edhe rubrikat e përmendura me sipër, konkretisht, të dhëna personale rreth familjes/fëmijëve, nëse janë duhanpirës apo jo. Megjithatë, edhe sikur mos të ishin plotësuar mjafton fakti që ky dokument mundet të plotësohet potencialisht nga personeli, si rrjedhojë përpunimi i këtyre të dhënave konsiderohet në kundërshtim me parashikimin e germës *“c”*, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit dhe me kriteret e përpunimit të parashikuar në nenin 6 të Ligjit.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë ato të dhëna që ka të nevojshme për të arritur qëllimin duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale, lidhur me mjaftueshmërinë e të dhënave, në të cilin parashikohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

- Sa i përket konstatimit të pikës 4 të procesverbalit, në lidhje me Kontratën e shërbimit, Kontrolluesi argumenton se *“Kontrata e shërbimit, datë 19.09.2018, lidhur me shoqërinë “RT Software group” sh.p.k, në nenin 4 “Detyrimet e Palëve” parashikon se, Pala e Dytë garanton sigurinë e plotë të Sistemit; Pala e Dytë*

duhet të ruajë fshehtësinë e të dhënave dhe përmbajtjen e databazës të Palës së Parë; Pala e Dytë, në lidhje me informacionin që do të marrë dhe trajtojë në bazë të kësaj kontrate dhe të përmbajtjes së databazës së sistemit, do t'i përmbahet legjislacionit mbi të dhënat personale.”

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimi i ngritur nga Kontrolluesi nuk qëndron pasi, në Kontratën e shërbimit, datë 19.09.2018, janë konstatuar mangësi lidhur me masat që Kontrolluesi duhet të marrë në rastin e delegimit të përpunimit tek palët e treta, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit. Zyra e Komisionerit në Udhëzimin nr. 11, ka parashikuar në detaje mënyrën e rregullimit të marrëdhënies midis Kontrolluesit dhe Përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit.

- Sa i përket konstatimit të pikës 5 të procesverbalit, në lidhje me Formularin e “Njoftimit”, Kontrolluesi argumenton se *“Njoftimi i përpunimit të të dhënave personale në Regjistrin Elektronik të subjekteve kontrolluese është realizuar për herë të parë nga përfaqësuesi i shoqërisë “Des Real Estate”, dhe ekzistenca e mangësive në deklaram lidhet me padijeninë e subjektit në plotësim ezaurues të rubrikave të saj dhe jo me neglizhencën apo evitimin në paraqitjen e këtyre të dhënave personale.”*

Zyra e Komisionerit vlerëson se procesi i “Njoftimit” është dinamik dhe kërkon një angazhim të vazhdueshëm nga Kontrolluesi për përditësimin e tij, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen qartësisht mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit.

- Sa i përket konstatimit të pikës 6 të procesverbalit, në lidhje me *“Rregulloren e mbrojtjes së të dhënave”*, Kontrolluesi argumenton se *“Shoqëria “Des Real Estate”, në kuadrin e saj rregullator, ka miratuar Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale”, me objekt përcaktimi i procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale nga strukturat e “Des Real Estate”. Në përmbajtjen e kësaj Rregullore, konkretisht në nenin 13 “Masat për sigurinë e të dhënave”, në nenin 14 “Mbrojtja e Ambjenteve”, në nenin 20 “Monitorimi dhe rregjistrimi i aksesit për të dhënat personale”, në nenin 23 “Ruajtja e dokumenteve sekrete”, në nenin 27 “Masat Administrative” si dhe në nenin 29 të saj “Konfidencialiteti për përpunimin e të dhënave”, parashikojnë në përputhje me ligjin nr. 9887/2008 së cilat janë proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin dhe afatet e mbrojtjes së të dhënave.”*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimi i ngritur nga Kontrolluesi nuk qëndron. Pavarësisht pretendimeve të ngritura nga Kontrolluesi, dokumenti i administruar nga grupi i kontrollit në cilësinë e provës material është bazuar në një model që është i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit. Ky model shërben për të orjentuar

Kontrolluesin lidhur me detyrimin e parashikimit të masave të sigurisë, që duhen ndërmarrë nga çdo kontrollues për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të hartojë një Rregullore specifike “për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në përputhje me veçoritë e aktivitetit që ushtron, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në zbatim të nenit 27 të Ligjit, në mënyrë që masat e sigurisë të parashikuara në këtë Rregullore të reflektojnë realisht përpunimin që kryen Kontrolluesi.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, në mënyrë që përpunimi mos të jetë në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, në përputhje me parashikimin e germës “c”, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit;
2. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete

teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi që kryen, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;

7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimin e treguar në pikat 1 dhe 2 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 3 dhe 5 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 4 dhe 6 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
10. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 16.6.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi